

KRONIKË E ZEZË

Të shtëna me armë në një aheng në Malishevë, policia gjen katër armë zjarri



Foto: Armet e sekuestruara në Malishevë/Foto: Policia e Kosovës

Grabitet një pompë e derivateve në Ferizaj
Arrestohet një grua në Prishtinë, nën ndikim të alkoolit sulmoi fizikisht një polic
Arrestohet i dyshuari për vrasjen e 5 gushtit në Lipjan
Një person gjendet i vdekur në Prishtinë
Kërkohet paraburgim ndaj të dyshuarit në Gjakovë që rrahu bashkëshorten
23-vjeçari plagoset me armë në Tiranë
Arrestohen pesë persona për “trafikim me qenie njerëzore dhe dhunim”

24 gusht 2022, 16:49

Shpërndaje në



Policia e Kosovës ka sekuestruar të mërkurën në fshatin Bubavec të Malishevës katër armë zjarri, pas kontrollit të realizuar, me t’u informuar për gjuajtje me armë në një aheng familjar.

Sipas njoftimit të policisë të mërkurën, armët e sekuestruara janë: një kallashnikov, një pushkë gjuetie, dy pistoleta me nga një karikator, 105 fishekë të llojeve të ndryshme dhe një gëzhjojë.

Janë arrestuar edhe dy të dyshuar në lidhje me rastin.

“Në zbatim të urdhërkontrollit të lëshuar nga Gjykata janë sekuestruar një pushkë automatike AK47 me një karikator, një pushkë gjuetie, dy pistoleta me nga një karikator dhe 105 fishekë të lloje të ndryshme si dhe një gëzhjojë. Lidhur me rastin, në cilësinë e të dyshuarve, janë arrestuar dy persona: N. K., shtetas i Republikës së Kosovës, lindur në vitin 1960 dhe G.K., shtetas i Republikës së Kosovës, lindur në vitin 1993”, thuhet në njoftim.

Sipas policisë, të dyshuarit, pas intervistimit, me vendim të Prokurorit të Shtetit janë liruar në procedurë të rregullt.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#MALISHEVË

#ARME ZJARRI

#GJUAJTJE NE AHENG FAMILJAR

TË TJERA



Avokatët e Krivaqës e Sejdiut kërkojnë hedhjen e aktakuzës për vrasjen e Marigona Osmanit



Shtyhet për në shtator seanca ndaj Shaban Gogajt, i akuzuar për vrasjen e Agonis Tetajt



Aktakuzë ndaj katër të dyshuarve për grabitjen e një marketi në Prizren



Shuhet zjarri në oborrin e Ministrisë së Infrastrukturës